




KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL II/2026

I mbajtur me rastin e mbledhjes së II (dytë) për vitin 2026 të Komitetit për
Komunitete Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 20.02.2026
Ora : 09:00

Prezentë:

Z. Shkendije Shabanj-Kryesuese

z.Nazim Shabanaj

znj.Merita Basha

z.Zek Berisha

znj.Amira Sofra

z.Aziz Bytyqi

z.Urim Suka

Të pranishëm tjerë:

Xheladin Sadikaj- Zyrtar për Kthim dhe Komunitete

Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore

Zyra për informim

Përfaqësues i OSBE-së

Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesja e cila propozoi këtë:

Rend Dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)
3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;
4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave;
5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale, “Stacioni i Autobusëve”;
6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale, “Eko-Regjionin”;
7. Të ndryshme;

Kryesuesja- Përhëndet të pranishmit dhe i njofton me rendin e ditës. E hedh në votim rendin e dities:

Unanimisht miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesja- e hedhë në votim pikën 1

Unanimisht miratohet

Pika2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)

Kryesuesja-e elaboron pikën dhe hap debatin

Urim Suka-përshendetje për të gjithë,projekt-vendimi për themelimin e KKSB-së themelimin e KKSB-së është një obligim që ne duhet me themelu edhe në bazë të ligjit dhe në shumicën e rasteve e përcakton edhe përbërjen mbi bazën e udhëzimit administrativ,por te pika 16 dhe 17 tek përfaqesuesja e shqiptarëve dhe përfaqesuesja e KPAK-së deshta me marrë sqarime sie si është bër zgjedhja për keta dy persona,se pak a shum qka pome shqetson kur e shikon përberjen komplet te këtij këshilli ti e vren që pushteti në këtë rast jan të gjithë se e kan me obligim DKA DSHP, Kryetari me qen këtu prezent mirpo kur po vjen puna te perfaqesimi opozites ketu asniher nuk po reflekton psh me qenë një përfaqesues i opozitës sepse nuk është që e specifikon edhe ligji me qenë ndoshta si këshill rekomandues qe është me pas qenë një zë i opozites në përbërje kishë qenë mirë.

Avni Bytyqi-po besojë që tash gjithë e dini që mandati i KKSB-së i mandatit te kalum i ka kalu afati dhe ne e kem obligim sipas udhëzimit administrativ me thenelu KKSB-Së ashtu siç e parasheh edhe ligji i Policisë së Kosovës dhe udhëzimi administrativ i Ministrisë së punëve të mbrendshme dhe MAPL-së i vitit 2012.Përbërja e këtij këshilli që shkon sipas detyres zyrtare Kryetari i Komunës,Komandanti i Policisë,Zyrtarja për barazi Gjimore,Përfaqesues i OSB-es,Përfaqesuesi i komitetit për komunitetit,Kryesuesja e Komunitetit për komunitete,shkon sipas detyrës zyrtare që e parasheh udhëzimi administrativ,ndërsa pjesa tjetër e këtij këshilli ne si Komun,unë në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës e kemi bër një thirrje publike ashtu siq e kërkon udhëzimi administrativ,dhe thirrja publike ka qenë 2 javë ditë e hapur dhe kan pas mundësi që ti japin propozimet e veta,sa i përket pikës 16 kjo është Përfaqësuesja e Komunitetit të personave em aftësi të kufizuar,ky propozim ka ardhë nga Qendra e Handikosit,ndërsa Luljeta Berisha ka ardhë nga

përfaqesuesit e Komunitetit Shqiptar dhe ky ka ardhë propozim nga një komunitet,të tjerët të gjithë jan me propozime,edhe te Kryetari i Këshillit të Prindërve DKA para dy jave me insistimin tim që ta mbajnë një takim dhe të bëjnë përzgjedhjen e Kryetarit të Këshillit të Prindërve dhe ai është Shpejtim Selimi.

Kryesuesja-e hedhë në votim

5 për,1 kundër miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesja-e elaboron pikën dhe hap debatin

Avni Bytyqi-nëse nuk gabojë në muajin Maj e kemi marrë një vendim për me i zhvillu procedurat e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtë të pronës publike bëhet fjalë për një parcelë në Biraq ,por përshkak që jan shpallë zgjedhjet nuk kemi pas mundësi me i vazhdu procedurat më tutje,andaj pasi tash është bër kompletimi i organeve të reja ne e kemi për obligim që ti kryejmë procedurat për me i zhvillu procedurat,Komisioni përbët prej 5 anëtarëve 2 nga Ekzekutivi 2 nga Kuvendi dhe një nga shoqëria civile.

Kryesuesja-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika4. .Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave;

Kryesuesja- e elaboron pikën dhe hap debatin

Avni Bytyqi-këtu bëhet fjalë për komisionin e ankesave që formohet nga Kuvendi për shqyrtimin e ankesave nga ofertuesve që janë të pa kënaqur të prones publike afatgjate dhe afatshkurtë,ky komision përbehet nga 5 anëtar,2 Ekzekutiv,2 Kuvend ,1 shoqëri civile,mandati i komisionit është 2 vjeçar.

Urim Suka-përbërja e komisionit 2 Ekzekutiv,2 Kuvend,1 Shoqëri Civile a është me udhëzim administrativ?

Avni Bytyqi-po është me udhëzim administrativ dhe nuk mundemi me ndryshu.

Kryesuesja- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale, “Stacioni i Autobusëve”;

Kryesuesja- e elaboron pikën dhe hap debatin

Avni Bytyqi-ligji për ndërmarrje publike e obligon Komunën që në secilen ndërmarrje publike që është aksionare të themeloj komisionin komunal për aksionarë,ne te stacioni autobusëve jemi 100% aksionarë por e kemi obligim ta themeloj Komisionin Komunal,dhe është mirë me shku dy pikat për një herë sepse është e njejta.

Kryesuesja- i hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Takimi përfundoi 09:15